



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 11, 12.2 shkronja d) dhe 17 shkronja h) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenit 5 shkronja d) të Ligjit nr.03/L-068 për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës, Udhëzimit Administrativ (MASH) nr.151/2020 për detyrat, përgjegjësitë procedurat dhe kriteret e zgjedhjes së drejtorit dhe zëvendës drejtorit të institucionit publik edukativo – arsimor dhe aftësues para universitar, neneve 14, 15 paragrafi 2.4 dhe 19 paragrafi 1.8 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.prot.01-020/01-0050862/18 të datës 29 qershor 2018, në propozim të Drejtorisë së Arsimit të Komunës së Podujevës, Kuvendi i Komunës ë Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 28 qershor 2021, miratoi këtë,

VENDIM PËR NGRITJEN E KOMISIONIT PËRZGJEDHËS

Neni 1

Për zhvillimin e procedurave për përzgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve në institucionet publike edukativo arsimore në Komunën e Podujevës, për një (1) vit shkollor, ngritet komisioni përzgjedhës, në përbërje:

1. **Blerim Vllasa**, zyrtar për arsimin e mesëm të lartë në Drejtorinë e Arsimit, kryesues
2. **Nazif Sheqa**, kryetar i Këshillit të prindërve, anëtar
3. Përfaqësues të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, që caktohet nga kjo Ministri
4. Nga shkolla përkatëse caktohen dy përfaqësues të Këshillit Drejtues (një prind dhe një mësuesimdhënës) në cilësinë e vëzhguesve.

Neni 2

Komisioni punët dhe detyrat i kryen në pajtim me dispozitat e Ligjit nr.03/L-068 për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës, dhe Udhëzimit Administrativ (MASH) nr.151/2020 për detyrat, përgjegjësitë procedurat dhe kriteret e zgjedhjes së drejtorit dhe zëvendës drejtorit të institucionit publik edukativo – arsimor dhe aftësues para universitar.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi kujdeset Drejtoria e Arsimit në Komunën e Podujevës.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës, përkatësisht konform nenit 81 të ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, dhe nenit 9 paragrafi 8 të Rregullores (QRK) nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave.

Nr.01-020/04-0051834/21
Podujevë, 28 qershor 2021

